

## **HAPET THIRRJA PËR APLIKIM PËR BURSA NË PROGRAMIN MEVLANA EXCHANGE, PËR STUDENTËT DHE STAFIN AKADEMIK PËR MËSIMDHËNIE, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019, NË UNIVERSITETIN KOCAELI, TURQI**

Në kuadër të Programit Mevlana Exchange është hapur thirrja për aplikim për bursa shkëmbimi për vitin akademik 2018-2019. Mevlana Exchange Programme është një program i cili mundëson shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Kocaeli.

Studentët e nivelit bachelor, master dhe Ph.D si dhe stafi akademik nga Universiteti i Tiranës kanë mundësinë të aplikojnë në Universitetin e Kocaeli-t në Turqi për bursa shkëmbimi.

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Bachelor;
- Master;
- Doktoraturë;

### **Llojet e mobilitetit për stafin:**

- Staf akademik për mësimdhënie;

### **Kohëzgjatja e bursave për studentët:**

- 4 muaj;

### **Kohëzgjatja e bursave për stafin akademik:**

- 2 javë;

### **Për t'u njohur me fushat e studimit ju lutem referohuni linkut:**

<http://mevlana.kocaeli.edu.tr/Dosyalar/Belgeler/MevlanaAlanKodlari.pdf>

### **Dokumentacioni për aplikim për studentët:**

Dokumentat e nevojshme për aplikim mund të shkarkohen në linkun:

[http://mevlana.kocaeli.edu.tr/index\\_en.php?enpages=page&id=documents](http://mevlana.kocaeli.edu.tr/index_en.php?enpages=page&id=documents)

### **Dokumentacioni për aplikim për stafin:**

Dokumentat e nevojshme për aplikim mund të shkarkohen në linkun:

[http://mevlana.kocaeli.edu.tr/index\\_en.php?enpages=page&id=documents](http://mevlana.kocaeli.edu.tr/index_en.php?enpages=page&id=documents)

**Kompensimi financiar për studentët:**

- Bursa për studentët është 1000 TL (Turkish Lira) për çdo muaj.
- Studentët e paguajnë pagesën e shkollimit në universitetin e vendit të tyre, pra ku ata janë regjistruar dhe nuk paguajnë asnjë pagesë tjetër shkollimi në universitetin pritës.

**Kompensimi financiar për stafin:**

Bursa e stafit përfshin:

- Kompensim ditor për stafin (50 TRY/ditë)
- Biletë udhëtimi (2500 TRY)

**Afati i aplikimit:** 26 Shkurt 2018

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi pranë Sektorit Marrëdhënieve me Jashtë në Rektoratin e Universitetit të Tiranës si edhe të skanuara përmes adresës [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Për më shumë informacion mbi bursat vizitoni: [http://mevlana.kocaeli.edu.tr/index\\_en.php](http://mevlana.kocaeli.edu.tr/index_en.php).